



z.Ali HAMITI
Kryesues i Bordit të ZRrE
Zyra e Rregullatorit për Energji
Rr. Hamdi Mramori nr.1 Prishtinë
10000

08.02.2010

SHTE4_Përgjigjet e KOSTT në Komentet e ZRrE lidhur me Aplikacionin Preliminar për të Hyra të Lejuara dhe Tarifa

I nderuar z. HAMITI,

Në bazë të letrës Tuaj të datës 19 janar 2010, **Komente ndaj Aplikacionit preliminar për të Hyra të Lejuara dhe Tarifa**, KOSTT ka shqyrtuar komentet dhe ka përgatitur përgjigjet.

Të bashkangjitur me këtë letër po Ju dërgojmë përgjigjet dhe arsyetimet përkatëse të paraqitura në dokumentet si vijon:

100208_SHTE4_Pergjigjet e KOSTT ndaj komenteve te ZRrE ne aplikacionin preliminar per tarifa.doc

100208_ETR4_KOSTT response to ERO commnets on preliminary tariff application.doc

100208_SHTE4_KOSTT_Shpensimet Kapitale.xls

100208_ETR4~Data Template~KOSTT.xls

100208_Shtojcë 1.doc


Dëshirojmë të ju bëjmë të ditur, se të dhënat e paraqitura në Modelin e Aplikacionit janë të dhëna për realizimin e pozicioneve përkatëse gjatë vitit 2009, të cilat janë të përcjellura edhe me listën e Projekteve Kapitale për vitet 2009-2012, si dhe me dokumentin e dhënë si Shtojcë 1, ku është dhënë një përmbledhje për efikasitetin e Sistemit të Transmisionit pas investimeve gjatë kësaj periudhe kohore dhe për pritjet në vitet e ardhme.

Shpresojmë që në përgjigjet e përgatitura dhe dokumentet e bashkangjitura për arsytetime më të hollësishme do të gjeni sqarimet e kërkuara.

Ju lutem që të konsideroni se jemi në disponimin Tuaj për çdo sqarim shtesë

Vlerësojmë bashkëpunimin tuaj dhe mbesim në pritje të përgjegjës.

Sinqerisht,



Fadil Ismajli
Kryeshf Ekzekutiv



- Cc. Theranda BEQIRI, Anëtare e Bordit të ZRrE, ZRrE
Nysret AVDIU, Anëtar i Bordit të ZRrE, ZRrE
Përparim KABASHI, Anëtar i Bordit të ZRrE, ZRrE
Blerim KOÇI, Anëtar i Bordit të ZRrE, ZRrE
Rifat BLAKAJ, Udhëheqës i Depart. për Furnizim me Energji dhe Strukturë të Tregut, ZRrE
Muharrem GASHI, Ekonomist për Çështje Rregullative, ZRrE
Afrim AJVAZI, u.d. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe të Licencave, ZRrE

OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU SH.A.
TRANSMISSION, SYSTEM AND MARKET OPERATOR J.S.C.
OPERATOR SISTEMA, PRENSA I TRŽIŠTA A.D.



SHTE4_Përgjigjet e KOSTT ndaj Komenteve të ZRrE lidhur me Aplikacionin Preliminar për të Hyra të Lejuara dhe Tarifa

Prishtinë
08 shkurt 2010

Hyrje

Ky dokument është përgjigja e KOSTT në komentet e Rregullatorit për aplikimin e Operatorit të Sistemit dhe Tregut të Kosovës për të Hyrat e Lejuara dhe Tarifave për rishikimin e katërt të tarifave të energjisë elektrike (SHTE4) të nxjerrë me 19 Janar 2010. Qëllimi i këtij dokumenti është të ofroj informata shtesë për të iu përgjigjur komenteve të Rregullatorit dhe të ndihmoj në ofrimin e qartësisë dhe bazës përkatëse për aplikacionin.

Ky dokument është hartuar në mënyre logjike t'i referohet dhe përgjigjet pikave sipas rendit të cilit janë ngritur në komentet e Rregullatorit.

Rritja e Përgjithshme e Kërkuar (Ref Komentet e ZRrE Pjesa 1 Hyrja)

Komentet e juaja në aplikacionin preliminar tregojnë një rritje në të hyrat e lejuara të kërkuara për 2010 prej 11.8%. nënkuptohet se kjo bazohet në kalkulimin i cili përfshinë përshtatjen në të hyrat e përgjithshme. Si metodë alternative e kalkulimit do të ishte thjeshtë të kalkulohet rritja e përgjithshme kërkuar në 2010 si përqindje e të Hyrat të Lejuara të 2009, si vijon:

	€m
2010 Të Hyrat e Kërkuara (Aplikacioni final)	19.119
2009 Të Hyrat e Lejuara	18.447
Rritja	672
Rritja e përqindjes	3.6%

Të hyrat aktuale të pranuar në 2009 ishin €18.792m. Prandaj, të hyrat e lejuara të kërkuara paraqesin një rritje prej vetëm 1.7% në të hyrat aktuale në 2009.


Kalkulimet finale të modelit të tarifave të ZRrE për 2009 (RTR3~RTM~17APR09~v9~ctr3) tregojnë se të hyrat e lejuara përgjithshme të KOSTT prej €18.447m përfaqësojnë 13.2 % të €139.787m të të hyrave të lejuara të përgjithshmet marra nga tarifave të energjisë elektrike (KEK dhe KOSTT). Ky proporcion i të hyrave të përgjithshme të rregulluara do të thotë se 3.6% të rritjes së kërkuar për të hyrat e lejuara do të paraqet një rritje prej vetëm prej 0.5% (13.2% x 3.6%) të tarifave të konsumatorëve në kthim të përmirësimeve të në sistemin e transmissioinit për të ofruar një gatishmëri dhe kualitet më të lartë të furnizimit.

Përmirësimet e Vazhdueshme

Në vitin 2009 vlera e energjisë elektrike të pa furnizuar është afërsisht 16% më e ulët në krahasim me vitin 2007.

Kjo rritje relativisht modeste duhet të shqyrtohet në kontekst të përmirësimeve të mëdha në sistemin elektrik të Kosovës të cilat KOSTT ka arritur:

- Reduktimi i humbjeve të transmisionit nga €6.580m në 2008 në €5.519m në 2009 (kursim prej €1.070m,lcvf);
- Niveli i energjisë së pa furnizuar për shkak të transmisionit vazhdon të bie ndjeshëm përgjatë periudhës tre vjeçare për të cilën janë vendosur tarifatat e KOSTT



- Me 25 Janar 2010 KOSTT ka përballuar një nivel rekord të kërkesës prej 1,170MW pa ndonjë reduktim të kërkesës për arsye të transmisionit. Në 2007 sistemi i transmisionit të KOSTT ka qenë në gjendje të përballojë kërkesën në vlerë vetëm diku rreth 900MW

Për të vazhduar me këtë trend të përmirësimeve në sistemin e transmisionit, si dhe përmbushjes së kërkesave të ENTSO-E, KOSTT-it duhet t'i lejohen të hyra të mjaftueshme për investimet kapitale në vazhdim dhe për trajnime, mbajtjen dhe motivimin e punëtorëve të vet.

Shpenzimet e Mirëmbajtjes (Ref Komentet e ZRrE Pjesa 2 Shpenzimet Operative 2.1 Shpenzimet e Mirëmbajtjes)

Ne kemi marrë në parasysh komentet e juaja për shpenzimet e kërkuara dhe aktuale për vitin 2010 dhe 2009 dhe trajtimin e kapitalizmit të shfrytëzuar. Për më tepër karshi informatave të ofruara me aplikacionin origjinal ne deklarojmë serish se baza e aplikacionit është:

- Në përputhshmëri me vitet paraprake;
- Në pajtim me Udhëzimet për Kontabilitetin Rregullativ seksioni 4.6 dhe 4.7;
- Pragmatik në lejimin e KOSTT të financoj programin për investime vitale i cili ka rezultuar në reduktimin vit për vit të humbjeve dhe rritjes së furnizimit që nga themelimi i KOSTT në 2006.

Ne pranojmë se nuk është zgjidhje aq elegante për të përmbushur nevojat e investimeve në transmissiionin e Kosovës dhe parashikojmë se dialogu i hapur me ZRrE në 2009 për të konsideruar ndryshimet e vlerave të aseteve të para 2006 mund të rezultojë në një zgjidhje më të qëndrueshme të financimit.

Projektet vijuese të cilat do të kapitalizohen janë të përfshira në dorëzimin për mirëmbajtje për vitin 2010.

Njësia e shpenzimeve	€
Zgjerimi i garazhës	150,000
Softueri (sistemet korporative – Financa, prokurim, BNj, etj)	200,000
Renovimi i fasadës të ndërtesës	300,000
Ndërtimi i kulmit	140,000
Sendërtimi i SCADA-lokale ne NS_për shkëmbim të të dhënave në kohe reale ndërmjet OST-OST	100,000
Kostot e realizuara të AGC	100,000
Nënstacioni Kosova B_ndërrimi i stabilimenteve te TL	1,600,000
Ndërrim i përçuesit, izolatorëve dhe pajisjeve lidhëse në linjën 126/5	340,000
	2,930,000

Zgjerimi i garazhës, renovimi i fasadës dhe ndërtimi i kulmit janë të nevojshme për të instaluar SCADA sistemin dhe për të përmirësuar sigurinë e qendrës së kontrollit.

Shpenzimet e Personelit (Ref Komentet e ZRrE Pjesa 2 Shpenzimet Operative 2.2 Shpenzimet e Personelit)

Numri i punëtorëve dhe Gatishmëria e Zyrave

Komenti juaj saktësisht vënë re se numri aktual i punëtorëve të KOSTT të punësuar në 2009 ka qenë 219, 15 punëtor më pak se për sa është aplikuar për dhe numrin e punëtorëve të lejuar prej 234 që përfaqëson një ulje prej 6%. Sidoqoftë, ngarkesa e punës së KOSTT është rritur sipas planit dhe punëtorët janë angazhuar jashtëzakonisht shumë për të tejkaluar mungesën e resurseve. Menaxhmenti i KOSTT ka përdorur dy taktika për të përballuar ngarkesën e punës në rritje, përkatësisht:

- Shtimi i punës jashtë orarit – gjithsejtë puna jashtë orarit gjatë periudhës ka qenë ekuivalente me 7 punëtorë me orar të plotë;
- Përdorimi i shtuar i punëtorëve të përkohshëm të – punëtorët e përkohshëm përdorur janë ekuivalent me 6 punëtor plotësues me orar të plotë.

Një nga faktorët kryesor kontribuues i cili ka penguar KOSTT që të përmbush numrin e punëtorëve në 2009 ka qenë mungesa e hapësirës. Diskutimet janë duke vazhduar me KEK që të lirojnë hapësirat plotësuese dhe pritet që KOSTT të ketë hapësira shtesë në dispozicion nga shkurti 2010.

Dorëzimi ynë për 2010 kërkon lejimin e 240 punëtorëve - dhe rritje prej 21 në 219 nga aktualja për 2009, por vetëm dhe rritje prej 8 kur konsiderohen 13 pozita shtesë të punuara me orar të plotë në 2009.

Nevoja për më shumë punëtorë në 2010 bazohet në:

- Rekrutimin e punëtorëve shtesë të mbuluar nga puna jashtë orarit dhe punëtorët e përkohshëm në 2009, kur të lirohen hapësirat;
- Implementimi i projektit të SCADA/EMS; dhe
- Përgatitja e implementimit të projektit NS Ferizaj 2 në 2011. Punëtorët do të rekrutohen dhe trajnohen plotësisht gjatë 2010 dhe të janë në gjendje të operojnë në 2011.

Shpenzimet e Punëtorëve

Shpenzimet e lejuara të punëtorëve për 2009 janë 2,272.3 m€ dhe për 2010 KOSTT ka aplikuar për vlerën 2,626.3 m€ për shpenzime të punëtorëve. Menaxhmaneti i KOSTT kujdesshëm ka kontrolluar shpenzimet e punëtorëve deri brenda €25 të mesatares së planifikuar gjatë 2009, si tregohet në tabelën vijuese.

Të lejuara 2009		Aktuale 2009	
2009 shpenz. e lejuara(€m)	2,272.3	2009 shpenz. aktuale (€m)	2,132.0
2009 punëtorët e lejuar	234.0	2009 punëtorët e aktual	219.0
2009 mesatarja e lejuar (€m)	9,710.7	2009 mesatarja aktuale (€m)	9,735.1

Një rritje mesatare prej 13% të shpenzimeve të punëtorëve është kërkuar në dorëzimin për 2010. Kjo përfshin një numër komponentësh, përfshirë performancën dhe elementet motivuese si në vijim:

- KOSTT ka implementuar Ligjin Themelor për Marrëdhëniet e Punës për mos diskriminimin e punëtorëve dhe ka miratuar pagesën e përvojës së punës edhe për punëtorët menaxhues si dhe punëtorët jo menaxhues (Bordi i Drejtorëve të KOSTT ka miratuar kalkulimin dhe pagesën e përvojës së punës edhe për punëtorët menaxhues gjatë 2010, kjo do të jetë €40,860 ose rritje prej 11.5%).
- KOSTT do të ofroj 5% pagesë për motivim dhe performancë në 2010 në mënyrë që të motivoj punëtorët të përmbushin planet strategjike dhe objektivat për vitin (vlera e performancës prej 5% do kërkoj buxhet në vlerë prej 131.315 € ose 37.1% të rritjes së kërkuar);
- KOSTT vazhdon të kërkoj individ të kualifikuar lartë dhe pozitave reja për operimin e SCADA/EMS dhe NS Ferizaj 2, të dyja do të rrisin proporcionin e punëtorëve me nivelin më të lartë të kualifikimeve, dhe prandaj edhe pagën mesatare.

KOSTT duhet të siguroj që pakoja e kompensimit të jetë mjaft atraktive të mbaj individët më të aftë sepse ka raste kur disave nga këta individë u janë ofruar paga më të mëdha jashtë vendit.

Për më tepër KOSTT investon ndjeshëm në trajnimin profesional të punëtorëve të vet për të mundësuar përmbushjen e kërkesave të reja legjislative dhe tjera, të vazhdoj të përmirësoj metodologjitë e tyre të punës dhe ofroj një ambient të sigurt pune. Në mënyrë që të përfitoj nga ky investim një nga objektivat strategjike është që të reduktoj rrezikun e humbjes së punëtorëve profesional duke qenë një punëdhënës atraktiv.

Pagesa e performancës motivuese është dëshmuar shumë efektive deri më tani në KOSTT, si është demonstruar më lartë. Sigurimi i shërbimeve të punëtorëve të vet derisa ata bëhen më shumë të trajnuar dhe me përvojë do të jetë një sfidë në rritje për organizatën.

Shpenzimet e Punëtorëve Krahasuar me KEK

Buxheti për shpenzime të punëtorëve në KOSTT përfaqëson 13.1% të të hyrave të përgjithshme, të kalkuluar sipas praktikave ndërkombëtare. Shifra e krahasueshme për KEK besohet të jetë rreth 30%.

Sipas Raporteve Vjetore të OST tjera Evropiane të publikuara në ueb faqet e tyre, kjo statistikë e krahasueshme gjatë 2008 ka qenë:

- EMS (Serbia): 16.8%¹
- ELIA (Belgjika): 18.2%²
- HEP (Kroacia 2007): 15.5%³

Është rasti i përgjithshëm se pagat mesatare të kompanive të transmisionit janë më të larta se sa në kompanitë e distribucionit. Kjo është e pritshme pasi që niveli i përgjithshëm i kualifikimeve dhe punëtorët me të aftë janë është më i lartë. Një shembull i këtij ndryshimi paraqitet në të dhënat vijuese nga llogaritë rregullative të MB 2009.

Shifrat për llogaritë rregullative 2009	National Grid (Transmision)	Central Networks East (Distribucion)	Central Networks West (Distribucion)
Shpenzimet e përgjithshme për paga	£141m	£55m	£67m
Numri i punëtorëve	2,352	1,199	1,345
Shpenzimi për Pagë Mesatare	£59,950	£45,871	£49,814
		Mesatarja e Distribucionit	£47,842

Përqindja e punëtorëve profesional të kualifikuar në KOSTT është 46%. Kjo ndjeshëm tejkalon atë të KEK e cila besohet të jetë më pak se 10%.

Të gjitha të lartshënuarat demonstronjë nevojën për rritjen e shpenzimeve të punëtorëve për 2010. Rritja prej **€354m** përfaqëson vetëm rritjen minimale për të arritur planet dhe qëllimet tona për 2010.

1

http://www.ems.rs/stranice/poslovne_informacije/re%20izvestaj/2008/Konsolidovani%20finansijski%20izvestaji%20JP%20EMS%20za%202008.%20g%20i%20izvestaj%20nezavisnog%20revizora%20po%20konsolidov%20fin.%20izvestajima%20JP%20EMS%20za%202008.pd

2

http://www.elia.be/repository/Lists/Library/Attachments/681/FY_2008_ResultsElia-v5.ppt

3

<http://www.hep.hr/hep/en/financial/Income.aspx> dhe <http://www.hep.hr/hep/publikacije/godisnje/2008godisnje.pdf>

Shërbimet Ndhimëse

Pyetjet e ZRrE-së janë:

- Deri më tani, ZRrE nuk ka pranuar asnjë informacion mbi kushtet e kësaj kontrate. Si lidhet furnizimi i rezervës nga këta generatorë, me detyrën e tyre për furnizim të gjithë kapacitetit të tyre ndaj furnizuesit publik nëse është e nevojshme?
 - KOSTT dëshiron të ju informojë se marrëveshja me KEK është nënshkruar kurse marrëveshja me KESH është përgatitur dhe është në pritje për t'u nënshkruar. Këto marrëveshje janë dërguar në ZRrE.
- A ka bërë KOSTT-i pagesë ndaj KEK-ut për blerjen e këtyre shërbimeve (në kesh)? Nëse po, atëherë kjo duhet të zbritet nga të hyrat e lejuara të KEK Gjenerimit prej shitjeve ndaj Furnizuesit Publik.
 - Marrëveshja për shërbimet ndihmëse është nënshkruar me datë 26.01.2010 dhe deri tani KOSTT nuk ka kryer ndonjë pagesë, çështje kjo e cila është e rregulluar me marrëveshje. Pagesat fillojnë pas implementimit të marrëveshjes.
- A është duke planifikuar KOSTT-i të paguajë KESH për prokurimin e rezervave sekondare? ZRrE nuk është e njohur për ndonjë pagesë në të kaluarën.
 - KOSTT do të paguajë për prokurimin e rezervës sekondare ndaj KESH në bazë të kushteve të marrëveshjes e cila pritet të nënshkruhet.
 - KOSTT nuk mund të bëjë një planifikim të mirëfilltë për pagesë lidhur me rezervën sekondare pasi që ajo varet nga data e nënshkrimit dhe kushtet e theksuara në marrëveshje.
- Në çka bazohen kostot e shërbimeve ndihmëse në aplikacionin tarifor? Totali është treguar të jetë €1,591,000 që është më i vogël sesa vlera që do t'i paguhet KEK Gjenerimit edhe para se të shtohen pagesat ndaj OST-së dhe KESH-it.
 - Vlera e dubur e Rezervës Sekondare llogaritet në bazë të formulës nga Doracaku i Operimit i UCTE-së, Politika 1 :

$$R = \sqrt{a L_{\max} + b^2} - b$$

R – Vlera minimale e Rregullimit sekondar në Më

L_{\max} – Ngarkesa pik në zonën rregulluese
 $a = 10 \text{ MW}$; $b = 150 \text{ MW}$

që do të thotë se vlera e rezervës ndryshon varësisht nga pikë maksimal.

Për vitin 2009 piku maksimal vjetor i planifikuar (sipas Bilancit vjetor Energjetik 2009) ka qenë 930MW që ka rezultuar me një kërkesë për rezervë sekondare $R = \pm 28.8$ MW. Çmimi i sigurimit të rezervës nga operatori fqinj EMS është llogaritur të jetë 6.3 € për MW. Kapaciteti i caktuar i rezervës duhet të jetë në disponueshmëri gjatë tërë vitit (8760h). Nga këto vlera është llogaritur kostoja e rezervës sekondare për vitin 2009 në vlerë 1 591 000 €.

$$(28.8 \times 8760 \times 6.3 = 1\,591\,000 \text{ €})$$

Për vitin 2010 piku i planifikuar është 1020MW (sipas Bilancit vjetor Energjetik 2010) që si pasojë ka një Rezervë Sekondare që sillet nga (± 22.1 deri ± 30.8) MW.

Çmimi i përdorur në kalkulim të koston vjetore për Rezervën Sekondare për vitin 2010 është 7€ për MW, çmim ky i propozuar në Marrëveshjen për Shërbimet Ndihmëse KOSTT-KEK (në proces është realizimi i marrëveshjes për sigurimin e Shërbimeve Ndihmëse, konkretisht Rezervës Sekondare, nga hidro njësitë gjeneruese të Shqipërisë - KESH).

$$\sum (R \times 720) \times 7 = 1\,623\,888 \text{ €}$$

R – vlera e rezervës së dubur çdo muaj gjatë vitit

2010	Jannar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
R(MW)	30.3	30.3	29.2	25.7	24.4	22.4	22.1	22.9	26.2	27.6	30.3	30.8

Pasi kapaciteti duhet të jetë në disponueshmëri gjatë tërë vitit (8760 orë) kurse TC Kosova B (e vetmja njësi gjeneruese e pajisur me AGC në Kosovë) është deklaruar se nuk është në gjendje që këtë rezervë të na garantojë gjatë tërë vitit pandërprerë atëherë KOSTT është detyruar që të kërkojë alternativa tjera të arsyeshme dhe teknikisht të realizueshme për të përmbushur kërkesën që rezervën sekondare ta ketë pandërprerë në dispozicion. Aktualisht është duke u shqyrtuar mundësia e kontraktimit të këtij shërbimi nga hidro njësitë gjeneratorike në Shqipëri (KESH).

Prandaj vlera e kalkuluar €1 623 888 pritet të mbulojë koston vjetore të sigurimit të kapacitetit të plotë të Rregullimit Sekondar për vitin 2010

- Në çfarë niveli janë kostot e vitit 2010, krahasuar me kostot aktuale të vitit 2009, të cilat janë raportuar dukshëm më të ulëta? A mund të ofrohet një ndarje e kostove të shërbimeve ndihmëse (e ndarë sipas vëllimit, çmimit dhe burimit)?
 - Niveli i kostove për shërbime ndihmëse për vitin 2010 është kalkuluar në bazë të rezervës adekuatë e cila duhet të jetë në disponim 24 orë për mbulimin e ndryshimit të ngarkesës. Kalkulimi i rezervës për rregullimin sekondarë është dhënë edhe në dokumentacionin Arsyeshmëria e të hyrave të lejuara. Kalkulimi I shpenzimeve për shërbime ndihmëse të realizuara në vitin 2009 është bërë në bazë të mesatares së realizuar sipas faturave të viteve të kaluara. Realizimi i vitit 2010 gjithashtu do të paraqitet në formë tabelore. Sidoqoftë, kostoja e këtyre shërbimeve do të jetë më e lartë për eficienta rritet meqenëse si zona rregulluese do të mund të inkasojmë të hyrat nga transiti dhe alokimi i kapaciteteve.

- Nëse KOSTT-i nuk është duke paguar shërbime ndihmëse, si janë duke u përdorur të hyrat e pranuar nga mbulimi i këtyre kostove?
 - *Për shkak se EMS nuk na i paguan shërbimet për alokimin e kapaciteteve të hyrat nga të cilat dedikohen për investime në transmision përkatësisht në interkoneksion, të hyrat për shërbimet ndihmëse janë ato që përdoren për këtë qëllim.*

Shpenzimet Tjera Operative e (Ref Komentet e ZRrE Pjesa 2 Shpenzimet Operative 2.4 Shpenzimet tjera)

Kjo kategori e kostove përfshinë shpenzimet e përgjithshme të cilat janë të nevojshme për KOSTT. Një shifër prej €1,385,784 kërkohet për 2010, të përgatitura në bazë konsistente me 2009. Shpenzimet më tutje janë detajuar si vijon:

	€	€ Komulative	% Komulative
Trajnimi	330,400	330,400	24%
Sigurimi i objekteve	205,000	535,400	39%
Sigurimi shëndetësor i Punëtorëve	127,000	662,400	48%
Karburantet	93,202	755,602	55%
Interneti dhe Telefonia	99,180	854,782	62%
Energjia elektrike	68,000	922,782	67%
Marketingu dhe Tenderimi	62,800	985,582	71%
Kontratat e përkohshme	58,000	1,043,582	75%
Mëditjet	52,082	1,095,664	79%
Disa Njësi më të Vogla <50k€	290,120	1,385,784	100%

Disa njësi më të vogla përfshijnë anëtarësimin, shpenzimet e regjistrimi të automjeteve, pajisjet e sigurisë, ngrohjen, ujin, literaturën, shpenzimet e auditimit, etj.

Për një numër i kategorive të shpenzimeve nevojitet rritje nga shifrat e 2009, pasi që ka qenë dhe janë të planifikuara një numër i etapash të rëndësishme për KOSTT në fund të 2009 dhe gjatë 2010, si vijon:

- Hapja e nënstacionit Peja 3 në vjeshtë 2009 ka rritur shpenzimet e ndërlidhura me energjinë elektrike, sigurimin, telefoninë, ujin, sigurimin dhe shpenzimet e tjera të imëta të ndërlidhura me pronën;
- Sistemi i ri SCADA i cili do të komisionohet në kuartalin e 4 të 2010 kërkon një investim shtesë në trajnimin dhe zhvillimin e cili tashmë ka filluar. Trajnimi është i shtrenjtë, dhe patjetër duhet të bëhet jashtë Kosovës;
- Përgatitja për anëtarësimin në ENTSO-E përsëri kërkon shpenzime shtesë të trajnimit, së bashku me udhëtime për takime.

Shpenzimet Kapitale e (Ref Komentet e ZRrE Pjesa 3 Shpenzimet Kapitale)

Përfitimet nga Programi i Investimeve të Planifikuara

Programi i shpenzimeve kapitale i përcaktuar në një Plan Investiv Detal, është dizajnuar për të arritur katër objektiva kryesore, si vijon.

- Rritja e përgjithshme e kapacitetit të rrjetit të transmisionit;
- Reduktimi i humbjeve të transmisionit (të planifikuara dhe jo të planifikuara);
- Përmirësimi i kualitetit të furnizimit; dhe
- Rritja e sigurisë së sistemit përfshirë edhe arritjen e standardit të sigurisë N-1.

Shtojca 1 e bashkangjitur kësaj përgjigjeje ofron një përmbledhje të secilit projekt kyç duke identifikuar kontributin e secilit në objektivat lartpërmendura, dhe prandaj pasojat e shtyrjes ose dështimit për të bërë investimin. Kurse përfitimi i projekteve individuale mund të vlerësohet, natyra e integruar e sistemit do të thotë se përfitimet më të gjëra do të arrihen nëpërmjet planit gjithë përfshirës. Tri tipet e investimeve të listuara janë përbërës thelbësor të programit të planifikuar:

- Përforcimi i linjave të transmisionit;
- Revitalizimi i nënstacioneve;
- Projektet që mbështesin operimin e sistemit.

Niveli i lartë i programit të investimeve shpie në disa rritje afatshkurta të nivelit të humbjeve për shkak të ndaljeve të planifikuara të nevojshme gjatë kësaj periudhe të nivelit të lartë investimeve kapitale.

Niveli i Zotimit të Financimit nga Donatorët

ZRrE ka kërkuar detale për nivelin e zotimit të financimit nga donatorët. 100% e financimit nga donatorët në aplikacionin për tarifa për 2010 është i zotuar.

Huazimet e pritura për 2010 dhe Kushtet

Ministria e Financave ka finalizuar një marrëveshje për Hua dhe Kontribut Financiar me KfW me një vlerë të përgjithshme prej €33,500,000 për finalizimin e projektit – Linja e Transmisionit 400kV Shqipëri – Kosovë, Transformatori dhe pajisjet për kontrollin e frekuencës së fuqisë. KOSTT është përfituesi i huasë.

Vlera e huasë do të jetë €17,000,000 euro dhe Kontributi Financiar (Donacion) do të jetë €16,500,000.

Periodha e ripagesës së huasë është 12 vjet me një grejs periudhë prej 3 viteve.

Norma e interesit do të kalkulohet në bazë të kostos efektive të financimit nga KfW plus një marginë prej 150 pikëve bazë.

Taksa e zotimit do të jetë 0.25% e shumës së pa shpenzuar të huasë.

Taksa e menaxhimit do të jetë 1 % e shumës së huasë.

Vlerësimet e Aseteve

Aplikacioni preliminar ka treguar se një aset i financuar pjesërisht prej €1.025m. Kjo ndërlidhet me djegien e një transformatori në Kosova A, i cili duhet urgjentisht të zëvendësohet. MEF është zotuar të financoj instalimin e transformatorit të rinë vlerë prej €2,844,981. Më vonë ka dalë se MEF do të jep vetëm €1,196,991 për zëvendësim. KOSTT pat hyrë në obligime kontraktuale për kryerjen e punës, dhe ashtu është obliguar të financoj koston e mbetur të këtij zëvendësimi në vlerë €1,255,557 gjatë 2009.

Shifra prej €1.025m ka qenë vlerë preliminare për shumën €1,255,557 e cila ka qenë rezultat final për 2009.

ZRrE gjithashtu ka pyetur se si është nxjere vlera e asetëve prej €53,825,000. Kjo shifër në aplikacionin preliminar ka qenë një gabim teknik i cili është përmirësuar në aplikacionin final.

Në aplikacionin final ne gjithashtu kemi përmirësuar shifrën e asetëve fillestare ashtu që të mos përfshij pagesat e avanseve sikurse ka bërë në vitet paraprake. Ne kuptojmë se kjo qasje e përmirësuar është në pajtim me metodologjinë e preferuar të ZRrE.

Bilanci Energjetik

KOSTT ka rishikuar shifrat tona për Bilancin Energjetik në dorëzimin tonë paraprak dhe konfirmon se ato janë të sakta. Ne nuk e dimë se si KEK kanë nxjerrë shifrat e tyre dhe ashtu nuk mund të komentojmë ato ose arsyet pse ato janë të ndryshme nga tonat.

Vërejtjet përfundimtare

Shpresojmë që ky dokument ka adresuar në tërësi çështjet e ngritura në komentet e ZRrE të datës 19 Janar 2010 dhe qartë demonstroi zotimin e KOSTT për përmirësimet e vazhdueshme për konsumatorët. KOSTT planifikon t'i bëjë këto përmirësime në një plan kohor të ngjeshur duke përcjelle objektivat më afatgjata strategjike të anëtarësimit në ENTSO-E për përfitimet e konsumatorëve për një rritje shumë modeste të tarifës së përgjithshme të energjisë elektrike.

Nëse ju nevojiten më shumë informata të cilat ne mund t'i japin të cilat mund të janë të dobishme për ZRrE ju lutem na njoftoni dhe ne do të jemi të kënaqur të ju ndihmojmë.

(Fund i dokumentit)

OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU SH.A.
TRANSMISSION, SYSTEM AND MARKET OPERATOR J.S.C.
OPERATOR SISTEMA, PRENOSA I TRZIŠTA A.D.



PROJEKTET KAPITALE NE RRJETIN E TRANSMISIONIT 2009-2012

**NDIKIMI I TYRE NE PERFORMANCEN E SISTEMIT TE
TRANSMISIONIT**

Prishtinë
08 shkurt 2010



1. PROJEKTET KAPITALE NE RRJETIN E TRANSMISIONIT

Në vijim do të paraqesim projektet te përforcimit të rrjetit 2009-2010, të cilat kategorizohen në projekte me këto veçori:

- Rritja e kapaciteteve të Transmisionit
- Reduktimi i humbjeve aktive dhe reaktive
- Rritja e kualitetit të furnizimit
- Rritja e sigurisë dhe besueshmërisë se Operimit të Sistemit Transmetues

1.1 PROJEKTET E PERFORCIMIT TE RRJETIT 2009/2010

Paket Projekti PEJA 3:

- AT1 400/110kV
- Kyçje ne linjën interkonektive L437
- Linja e re 110kV Peja 3- Klina
- Ndërrim përqyesi i L126/4
- Kyçje e NS Skenderaj ne L163
- Ndërrim përqyesi e linjës Skenderaj-Peja 3

NS Skenderaj 110/10kV

Deri ne fund te marsit 2010 pritet te kryhet edhe NS Skenderaj me çrast bëhet kompletimi i projektit

Ndikimet: Përforcim i rrjetit të transmisionit me qellim të eliminimit të fyteve të ngushta, reduktimin e ndjeshëm të humbjeve aktive dhe reaktive, përmirësimin e profilit të tensioneve dhe rritjen e sigurisë dhe besueshmërisë së furnizimit të konsumit. Projekti ka ndikuar në rritjen prej 270MW të kapaciteteve të rrjetit të Transmisionit. Gjithashtu është përmirësuar kriteri i sigurisë N-1

AT1-150MVA ne NS Kosova A

(a) Autotransformatori 150MVA, 220/110kV zëvendëson autotransformatorin e djegur AT1-100MVA.

Projekti ka përfunduar në dhjetor 2009

Ndikimet: Rritja e kapaciteteve të Transformimit, eliminimi i fytit të ngushtë në Transformimin 220/110kV, optimizmi i punës së tre autotransformatorëve dhe plotësimi i kriterit te sigurisë N-1. Gjithashtu ndikon ndjeshëm në reduktimin e humbjeve aktive dhe reaktive pas aktivizimit të rregullatorëve të Tensionit



Adaptimi i linjës L212 si linjë 110kV NS Kosova A-NS Ferizaj 1

- Riparimi i linjës me parametra të mëparshëm nga NS Kosova A deri në NS Ferizaj-1 31km
- Ndërtimi i fushës së linjës 110kV në NS Ferizaj 1
- Kyçja në zbarrat 110kV në NS Kosova A

Projekti pritet të përfundoj në gjysmën e shkurtit 2010

Ndikimet: Përforsim emergjent i rrjetit të transmissiionit në zonën e Kosovës Jug-lindore me qëllim të eliminimit të fyteve të ngushta në rrjetin 110kV dhe rritjes së kualitetit dhe besueshmërisë të furnizimit të konsumit në atë zonë. Ky projekt do të ndikojë në shkarkimin e linjës problematike NS Prishtina 4 – NS Ferizaj 1 si dhe të autotransformatorëve në NS Prishtina 4. Kriteri i sigurisë N-1 do të përmirësohet.

Përforsim i linjës 110kV, L 126/1,

- Ndërtimi i përçuesit nga 150mm² në 240mm² me gjatësi 20.2km. Përforsimi i shtyllave ekzistuese dhe ndërtimi i katër shtyllave të reja.

Projekti ka përfunduar në Korrik 2009

Ndikimet: Rritja e kapacitetit transmetues të linjës nga 83MVA në 114MVA e cila paraqet pjesë të unazës së rëndësishme 110kV: Gjakova2-Gjakova1-Deçan-Peja1&2- Peja3.Ndërtimi i përçuesit ndikon në uljen e humbjeve në këtë linjë.

5. AT3150MVA në NS Prishtina 4

- Instalimi i autotransformatorit të tretë 150MVA, 220/110kVsi dhe ndërtimi i bazamenteve të transformatorit
- Ndërtimi i fushave transformatorike

Projekti pritet të përfundoj në gjysmën e marsit 2010

Ndikimet: Rritja e kapaciteteve të Transformimit për 150MVA, eliminimi i fytit të ngushtë në Transformimin 220/110kV në NS Prishtina 4, dhe plotësimi i kriterit të sigurisë N-1 në aspektin e transformimit. Autotransformatori i tretë do të mundësojë optimizimin e punës gjatë procesit të mirëmbajtjes së NS Prishtina 4.

1.2 PROJEKTET E RI_VITALIZIMIT TE NENSTACIONEVE 2009/2010

Në vijim do të paraqesim projektet e kategorisë së ri-vitalizimit të nënstacioneve për periudhën kohore 2009-2010 .



Ri-vitalizimi i nënstacionit TS Kosova –A

- Sistemi 220kV
- Sistemi 110kV
- Objekti i Komandimit

Projekti pritet të përfundoj ne kuartalin e dytë 2010

Ndikimet: Rritja e sigurisë dhe besueshmërisë së Operimit të Nënstacionit Kosova- A i cili paraqet nyje e rëndësisë së lartë për SEE të Kosovës. Ky nënstacion karakterizohet me rryma shumë të mëdha të prishjeve, andaj ndërrimi i pajisjeve të Tensionit të Lartë do të sjellë siguri të lartë në Operimin e këtij nënstacioni

Ri-vitalizimi i nënstacionit Kosova B-400 kV

- Ndërrim i pajisjeve të TL 400kV.
- Ndërrim i pajisjeve të TL 220kV.

Ana 220kV ka filluar ne vitin 2009 dhe një pjesë e madhe e fushave janë ndërruar ndërsa pjesa e mbetur dhe ajo e nivelit 400kV pritet të përfundoj ne kuartalin e katërt 2010

Ndikimet: Rritja e sigurisë dhe besueshmërisë së Operimit të nënstacionit kryesor të KOSTT-it. Zhvillimi i këtij projekti ka rëndësi edhe regionale pasi që në këtë nënstacion janë të kyçura aktualisht tri linja interkonektive dhe deri ne fund te vitit 2012 pritet te kyçet edhe linja e katërt interkonektive 400kV Kosova B – Tiranana 2.

Re-Vitalizimi i nënstacionit TS Prishtina 1

- Sistemi 110kV

Projekti ka përfunduar në vitin 2009

Ndikimet: Rritja e sigurisë dhe besueshmërisë së Operimit të Nënstacionit Prishtina-1 me ndikim edhe në nënstacionet tjera të cilat lidhen me NS Prishtina 1

1.3 PROJEKTET E MBESHTETJES SE SISTEMIT TRANSMETUES 2009/2010

Në vijim do të paraqesim projektet e kategorisë mbështetëse të Sistemit të Transmisionit qe kanë këto veçori:

- Matje të energjisë
- Komandim i Operimit të Sistemit
- Kontroll apo monitorimi i Operimit të Sistemit
- Mbrojtje e Sistemit



ITSMO Njehsorët (ne kufi)

- Instalimi i grupeve të reja matëse në pikat kufitare të rrjetit të KOSTT-it
- Instalimi i aplikacionit për grumbullimin e madhësive matëse
Projekti ka përfunduar në vitin 2009

Ndikimet: Plotësimi i kriterëve teknike nga Kodi i Matjeve dhe kriterëve të kërkuara nga ENTSO/E

SCADA-EMS

- Sistemi Qendror i SCADA/EMS në Qndren nacionale Disqeçerike
- SCADA në nënstacione
- Rrugët telekomunikuese

Projekti ka filluar se implementuari në vitin 2009 dhe pritet të përfundoj në fund të vitit 2010-02-04

Ndikimet: Përmes projektit SCADA/EMS Sistemi i Transmisionit të KOSTT-it plotëson kriteret teknike të kërkuara nga ENTSO/E. Me këtë rast projekti do të mundësojë operim optimal të Sistemit të Transmisionit përmes pajisjeve moderne të sistemit SCADA/EMS

LFC Rregullimi Sekondar

- Integrimi i dy Sistemeve të Shqipërisë dhe Kosovës në aspektin e rregullimit sekondar të përbashkët

Projekti pritet të përfundoj në kuartalin e dytë 2011

Ndikimet: Me këtë projekt KOSTT-i plotëson kriterin kryesor të kërkuar nga ENTSO/E dhe nga standardet e përcaktuara në kodin rregullimit të frekuencës (brenda kodit të balancit).

1.4 EFEKTET E PROJEKTEVE 2009/2010 NE PERFORMANCEN E RRJETIT

Pas përfundimit të projekteve 2009/2010, kapaciteti bartës i rrjetit do të rritet nga 930MW në **1250MW** që do të thotë se rrjeti i Transmisionit do ta kalojë fazën kritike të aftësive bartëse dhe me rritjen prej 34% të kapaciteteve do të avancohet në një rrjet relativisht operativ dhe të sigurt në aspektin e kriterit N.

Analizat kompjuterike tregojnë efektin tejet pozitiv të përforsimeve të rrjetit të Transmisionit në përmirësimin e përmbushjes së kriterit të sigurisë N-1. Rrjeti mund të operojë sipas kriterit N-1 deri në konsumin **810MW** pa marrë në konsideratë dy linjat radiale. Pra duke krahasuar me gjendjen e mëhershme projektet do të ndikojnë në rritje 25% të kapacitetit të Transmisionit sipas kriterit të sigurisë N-1. Kjo mund të shihet në fig.1




Fig. 1 Zhvillimi i kapaciteteve të rrjetit të Transmisionit të planifikuara kundrejt konsumit nga 2008 deri në vitin 2010

Ndikimet kryesore të projekteve në implementim në rrjetin e Transmisionit rezultojnë në përmirësimin e dukshëm të profilit të tensioneve, i cili në disa pjesë të rrjetit 110kV të Transmisionit paraprakisht nuk ka plotësuar as kriteret minimale teknike. Dy projektet vendimtare të cilat ndikojnë në ngritje të nivelit të tensioneve pothuajse në të gjitha nyjet e nivelit 110kV janë: projekti Peja 3 dhe projekti i konvertimit të linjës L212 në linjë 110kV. Këto dy projekte do të ofrojnë njeje aktualisht më të dobëta injektim të mjaftueshëm të fuqisë aktive dhe reaktive, duke relaksuar degët tjera të rrjetit, duke ndikuar drejtpërsëdrejti në rritjen e nivelit të tensioneve, reduktimin e humbjeve aktive dhe reaktive.

Në fig.2 mund të shihet ndikimi i projekteve në përmirësimin e profilit të tensioneve në të gjitha nyjet 110kV




Fig. 2 Krahasimi i profilit të tensioneve para dhe pas përfortimeve 2009/2010



2. PROJEKTET NE RRJETIN E TRANSMISIONIT 2011/2012

Në vijim janë paraqitur projektet kryesore 2011/2012 të cilat kategorizohen në projekte me ndikim në rritjen e kapaciteteve të Transmisionit, reduktimin e humbjeve, rritjen e sigurisë dhe besueshmërisë si dhe kualitetit të furnizimit.

2.1 PROJEKTET E PERFORCIMIT TE RRJETIT 2011/2012

Paket Projekti FERIZAJ 2:

- AT1 400/110kV, 300MVA
- Kyçje ne linjën interkonektive L420
- Linja e dyfishtë 110kV Ferizaj 2- Ferizaj 1
- Linja 110kV Ferizaj 2 – Gjilan 5
- Fusha të linjave 110kV në NS Ferizaj 1

Projekti parashihet të përfundoj ne kuartalin e katërt 2011

Ndikimet: Përforcim i rrjetit të transmisionit me qëllim të eliminimit të fyteve të ngushta, reduktimin e humbjeve aktive dhe reaktive, përmirësimin e profilit të tensioneve dhe rritjen e sigurisë dhe besueshmërisë së furnizimit të konsumit në pjesën jug-lindore të rrjetit të Transmisionit.

Linja interkonektive 400kV Kosova B-Kashar

- Linja 400kV
- Fusha e linjës 400kV ne NS Kosova B

Projekti parashihet të përfundoj ne kuartalin e katërt 2012

Ndikimet: Përforcim i rrjetit horizontal me ndikim regional. Optimizim i operimit të dy sistemeve te ndërlidhura. Eliminim i fyteve te ngushta ne rrjetin regional. Linja do të mundësoj rritjen e kapaciteteve të interkoneksionit për 600MW.

AT3-150MVA ne NS Prizren 2

- Instalimi i autotransformatorit të tretë 150MVA, 220/110kVsi dhe ndërtimi i bazamenteve të transformatorit
- Ndërtimi i fushave transformatorike

Projekti parashihet të përfundoj ne kuartalin e dytë 2011

Ndikimet: Rritja e kapaciteteve të Transformimit, eliminimi i fytit të ngushtë në Transformimin 220/110kV në NS Prizreni 2 , dhe plotësimi i kriterit te sigurisë N-1.Projekti do të mundësoj furnizim të besueshëm dhe të sigurt të konsumit të rajonit të Prizrenit, Gjakovës, Therandës dhe Rahovecit.



SSH Shtime, 110kV¹

- Linja e re 110kV NS Lipjan SS Shtime
- Kycja me linjë te dyfishtë 110kV në linjën ekzistuese NS Ferizaj 1 – NS Theranda

Projekti parashihet të përfundoj ne kuartalin e parë 2012

Ndikimet: Me këtë projekt mundësohet furnizimi unazor i NS Lipjanit, me ndikim te drejtpërdrejtë në plotësimin e kriterit N-1, duke mundësuar optimizim të procesit të mirëmbajtjes si dhe rritjen e sigurisë dhe besueshmërisë se operimit të sistemit.

2.2 PROJEKTET E RI_VITALIZIMIT TE NENSTACIONEVE 2011/2012

Në vijim do të paraqesim projektet e kategorisë së ri-vitalizimit të nënstacioneve për periudhën kohore 2011-2012 .

Ri-vitalizimi i paisjeve te TL Prizreni-2 220 &110kV & mbrojtjes

- Ndërrimi i pajisjeve të TL
- Ndërrimi i sistemit të matjeve, mbrojtjes .

Projekti parashihet të përfundoj ne kuartalin e tretë 2011

Ndikimet: Rritja e sigurisë dhe besueshmërisë së Operimit të nënstacionit shumë të rëndësishëm 220/110kV me ndikim rajonal.

Ri-vitalizimi i paisjeve te TL Peja-1 110kV

- Ndërrim i pajisjeve të TL 110kV.
- Ri-konfigurimi i sistemit të zbarrave

Ri-vitalizimi i paisjeve te TL Ferizaj 1 110kV

- Ndërrim i pajisjeve të TL 110kV.
- Ri-konfigurimi i sistemit të zbarrave

Ri-vitalizimi i paisjeve te TL Vallaqi 110kV

- Ndërrim i pajisjeve të TL 110kV.
- Ndërtimi i fushës lidhëse 110kV

Ri-vitalizimi i paisjeve te TL Gjakova-1 110kV

- Ndërrim i pajisjeve të TL 110kV.
- Ri-konfigurimi i sistemit të zbarrave

Projektet planifikohen të kryhen gjatë periudhës kohore 2011-2012

Ndikimet: Rritja e sigurisë dhe besueshmërisë së operimit të këtyre nënstacioneve

¹ Projekti ka disa opsione te zhvillimit, e cila varet nga kërkesa e Shperndarjes apo gjeneratoreve me ere. Ne kete rsst Stcioni Shperndares konvertohet ne nenstacion per nevojat e perkrahjes se konsumit ne Shtime si dhe per kycjen e kapaciteteve gjeneruese nga era ne rast se ato zhvillohen.



2.3 PROJEKTET E MBESHTETJES SE SISTEMIT TRANSMETUES 2011/2012

Në vijim do të paraqesim projektet e kategorisë mbështetëse të Sistemit të Transmisionit për periudhën kohore 2011-2012 .

INSTALIMI I OPGW në linjat interkonektive 400kV

- Instalimi i rrugëve telekomunikuese përmes fije optike në linjat interkonektive 400kV dhe 220kV deri në kufij.

Projektet planifikohen të kryhen në kuartalin e dytë të vitit 2011

Ndikimet: Projekti do të mundësojë plotësimin e kërkesave që dalin nga polisa 6 e doracakut të ENTSO/E

SISTEMI TI-ve për të mbështetur Operimet e Tregut

- Sistemi qendror për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave
- Pajisjet harduerike dhe softuerike

Projektet planifikohen të kryhen në kuartalin e katërt të vitit 2011

Ndikimet:Projekti mundëson për të menaxhuar shkëmbimin e të dhënave, që kanë të bëjnë me tregun dhe ndërlihdjet ndërmjet OST-ve dhe pjesëmarrësve të ndryshëm në tregun e energjisë

2.4 EFEKTET E PROJEKTEVE 2011/2012 NE PERFORMANCEN E RRJETIT

Pas përfundimit të projekteve të lartpërmendura kapaciteti bartës i rrjetit do të rritet nga 1250MW në **1550MW**, që do të thotë që rrjeti i Transmisionit do ta kalojë nga faza e konsolidimit në fazën e avancuar, me rritje të kapaciteteve bartëse prej 66.7% krahasuar me gjendjen e aktuale. Për konsumin e parashikuar 1112MW rrjeti i Transmisionit operon me marginë të lartë të sigurisë. Në rrjet nuk identifikohen elemente të mbingarkuara dhe tensionet në të gjitha nyejt janë në brezin e lejuar sipas kodit të rrjetit. Linja e re interkonektive 400kV Kosova B – Tërana 2, do të mundësojë rritjen e kapaciteteve të interkoneksionit për 600MW duke krijuar një korridor shumë të rëndësishëm për bartjen e energjisë elektrike jo vetëm për dy vendet të cilat ndërlihdhen por për tërë rajonin. Linja do të mundësojë rritjen e kapaciteteve gjeneruese në të dy vendet.

Analizat kompjuterike tregojnë efektin pozitiv të përforcimeve në aspektin e përmirësimit të përmbushjes së kriterit të sigurisë N-1. Llinja radiale e cila furnizon NS Rahoveci nuk plotëson kriterin N-1, ndërsa të gjitha elementet tjera plotësojnë kriterin N-1. Simulimet tregojnë që kapaciteti bartës i rrjetit për N-1 do të arrijë vlerën **1100MW**.

Në fig. 3 mund të shihet diagrami i cili tregon zhvillimin e kapaciteteve bartëse nga 2009 deri në 2011.




Fig. 3 Zhvillimi i kapaciteteve të rrjetit të Transmisionit të planifikuara kundrejt konsumit nga 2009 deri në vitin 2012

Projektet vendimtare të cilat ndikojnë në ngritje të nivelit të tensioneve në zbarrat 110kV janë: projekti Ferizaj 2 si dhe rritja e kapaciteteve bartëse të linjave 110kV. Në fig. 4 janë paraqitur dy diagramet e profilit të tensioneve para dhe pas përforcimeve të periudhës kohore 2011. Qartë mund të shihen efektet e projekteve në ngritjen e nivelit të tensioneve. Në të gjitha nyjet e shpërndarjes niveli i tensioneve gjendet në kufijtë e lejuar dhe shumë afër vlerës nominale 110kV në pajtueshmëri të plotë me Kodin e Rrjetit.




Fig. 4 Krahasimi i profilit të tensioneve 2009-2011

Krijimi i njëjës së fuqishme NS Ferizaj 2, si dhe përforcimet në kapacitetin e disa linjave 110kV, dukshëm do të kontribuojnë në reduktimin e mëtutjeshëm të humbjeve aktive dhe reaktive në sistemin e Transmisionit.